

VENDIM
Nr.1383, datë 17.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BICAJ, TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bicaj, të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Bicaj, të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.508, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bicaj, të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bicaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bicaj

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji transferimit
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
51,52	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administrative	Në pronësi
15-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
23-27, 29-30	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
31-50	Varreza publike	Në pronësi
54-148	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
149,150,153,157,158,161,162, 165,166,167,170,171,174,175, 177-179,182,183,186-188	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
151,152,155,156,159,160, 163,164,168,169,172,173, 176,180,181,184,185,189, 190,191	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

154	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
-----	---	------------